

**STATUTI I SHOQERISE**  
**"PROWAY GROUP" Sh.p.k**

Ne kete statut

- "Ligji" eshte Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare";
- "Statuti" eshte Statuti i shoqerise;

**Kreu I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia**

**Neni 1:**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

(1) Sot, me 29/09/2021 une themeluesit, kam krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin "**Proway Group**" SH.P.K.

(2) Themeluesi i shoqërisë është:

Z. Ergis Mehillka, shtetas shqiptar, lindur më 22.12.1992 në Bubullimë ,Lushnjë ,Shqipëri, identifikuar me nr identifikimi J21222023G, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.

**Neni 2:**

**Objekti**

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem:

2.1 Te operoje ne sektorin e telekomunikacionit duke kryer cdo lloj veprimtarie nepermjet telefonit per llogari te vet apo te treteve me seli ne Shqiperi apo ne cdo vend tjetet qe ka lidhje me Republiken e Shqiperise, duke respektuar ligjin ne fuqi; -Te kryej aktivite nepermjet telefonit te cdo lloji per llogari te vet apo te treteve, telemarketing, sekretari telefonike, shitje nepermjet telefonit, sondazhe, mesazhe promocionale dhe cdo lloj tjetet aktiviteti lidhur me te, ku persa permendur me siper nuk mund te jete saktesisht apo e kufizuar; -.Aktivite import-eksporti te makinerive e pajisjeve te fushes se telekomunikacionit. Import-eksport per mallra te ndryshme per nevoja te ushtrimit te aktivitetit te shoqerise.Te bleje e te shese ose te jape me qera, ne perdorim, ne uzufrukt, ose ne shfrytezim pasuri te luajtshme e pasuri te paluajtshme e te regjistruara ne regjistrat publike.

2.2 Gjithashtu shoqëria mund te kryeje cdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë cdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

2.3 Shoqëria, me vendim të Administratorit, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.

**Neni 3:**

**Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqerise do te jete pa afat.



**Neni 4:  
Selia**

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: : Tirane ,Njesia bashkiake nr 8,Rruga e Saraceve,pallati nr 112/1, nr 1 , kodi postar 1017.

**Kreu II Kapitali**

**Neni 5  
Kapitali themeltar**

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100.000 (njqind mije) leke dhe nuk eshte paguar.

Pjesemarrja e themeluesit ne kapitalin e shoqerise eshte si me poshte:

Z. Ergis Mëhillka: Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere të përgjithshme 100,000 (njqind mije) leke qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

**Neni 6:**

**Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

**Neni 7**

**Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- 5) dhurimit;
- d) cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.



## KREU III

### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

#### Neni 8

##### Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme: a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;

b) ndryshimet e statutit;

c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;

d) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;

e) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "5" te kesaj

pike;

dh) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;

e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;

f) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;

g) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

h) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;

h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;

i) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

#### Neni 9

##### Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vonë se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur si me sipër, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortakët jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullise.

#### Neni 10

##### Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortakët me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 70 per qind te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortakët qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.



Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorunit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

### **Neni 11 Marrja e vendimeve**

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndajen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
  - b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
  - c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
  - d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
  - e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

### **Neni 12 Perjashtimi nga e drejta e votes**

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

### **Neni 13 Administrimi**

13.1 Personi i meposhtem caktohet si Administrator i pare i shoqerise:

- Z. Ergis Mehillka, shtetas shqiptar, lindur më 22.12.1992 në Bubullimë, Lushnjë, Shqipëri, identifikuar me nr identifikimi J21222023G, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar I cili emerohet per nje periudhe 5 (pese) vjecare

Nenshkrimi I administratorit 

### **Neni 14 Kompetencat e Administratoreve**

Administratori kane te drejte e detyrohet te:

- a) kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesoje shoqerine tregtare;
- c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- ç) pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;



- d) krijon nje sistem paralajmerimi ne kohën e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- dh) kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise, si parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- e) raporton perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- e) kryen detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

#### **Neni15 Pergjegjesite e Administratorit**

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Perveç sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

- a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;
- b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- c) te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendim;
- ç) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;
- d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

#### **Kreu IV Viti financiar**

##### **Neni16**

##### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### **Kreu V Prishja-riorganizimi i shoqerise**

##### **Neni17**

##### **Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- b) me hapjen e procedurave te falimentimit;

##### **Neni18 Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja**

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare."



## **Neni 19**

### **Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

## **Neni 20**

### **Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare e Rrethit Gjyqesor Tirane.

## **NENI 21**

### **Kopjet**

Ky dokument redaktohet ne 3 (tre) kopje origjinale.

Lexuar, kuptuar, aprovuar e nenshkruar nga ortaku themelues.

**ORTAKU THEMELUES**

**Z.Ergis Mëhillka**



**Data: 29/09/2021**



**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**“PROWAY GROUP” Sh.p.k**

*I. THEMELIMI*

**NENI 1  
Ortaket themelues**

Shoqeria krijohet nga ortaku themelues:

- Z. Ergis Mëhillka, shtetas shqiptar, lindur më 22.12.1992 në Bubullimë ,Lushnjë ,Shqipëri, identifikuar me nr identifikimi J21222023G, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.

*II. EMERTIMI – SELIA – FORMA JURIDIKE - OBJEKTI*

**NENI 2  
Emertimi**

Shoqeria emertohet **“Proway Group” Sh.p.k**

**NENI 3  
Forma juridike**

Forma juridike do te jete shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (Sh.p.k.) sipas Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per shoqerite Tregtare”.

**NENI 4  
Selia**

4.1 Shoqeria **“Proway Group” Sh.p.k** e ka seline e saj ne adresen: Tirane ,Njesia bashkiake nr 8,Rruga e Saraceve,pallati nr 112/1, nr 1 , kodi postar 1017.

4.2 Shoqeria vepron si person juridik shqiptar dhe si e tillë mund te kryeje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise ose jashte saj, nepermjet filialeve, degeve, zyrave te perfaqesimit ose agjensite e saj, te cilat jane krijuar me vendim të Asamblesë së Pergjithshme të Shoqerise dhe do te veprojne nen mbikqyrjen e Administratorëve të **“Proway Group” Sh.p.k.**

**NENI 5  
Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë**

5.1. Shoqëria **“Proway Group” Sh.p.k** ushtron veprimtarinë e saj me qëllim realizimin e fitimit, duke u mbështetur në parimet dhe rregullat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar.



5.2. Veprimtaria e Shoqërisë “**Proway Group**” Sh.p.k, do të ketë për objekt: Te operoje ne sektorin e telekomunikacionit duke kryer cdo lloj veprimtarie nepermjet telefonit per llogari te vet apo te treteve me seli ne Shqiperi apo ne cdo vend tjetër qe ka lidhje me Republikën e Shqiperise, duke respektuar ligjin ne fuqi; -Te kryej aktivitete nepermjet telefonit te cdo lloji per llogari te vet apo te treteve, telemarketing, sekretari telefonike, shitje nepermjet telefonit, sondazhe, mesazhe promociionale dhe cdo lloj tjetër aktiviteti lidhur me te, ku persa permendur me siper nuk mund te jete saktesisht apo e kufizuar; - .Aktivitete import-eksporti te makinerive e pajisjeve te fushes se telekomunikacionit. Import-eksport per mallra te ndryshme per nevoja te ushtrimit te aktivitetit te shoqerise.Te bleje e te shese ose te jape me qera, ne perdorim, ne uzufukt, ose ne shfrytezim pasuri te luajtshme e pasuri te paluajtshme e te regjistruara ne regjistrat publike.

5.3 Shoqëria mund te kryeje cdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë cdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj;

5.4 Shoqëria, me vendim të Administratorit, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.

5.5 Objekti i shoqerise mund te ndryshoje, te zgjerohet ose te pakesohet ne baze te vendimit te Asamblese se Pergjithshme.

### III. KOHEZGJATJA – KAPITALI I SHOQERISE-VENDIMARRJA

#### NENI 6 Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine per nje periudhe kohore te pacaktuar.

#### NENI 7 Kapitali i Shoqerise

7.1 Kapitali themeltar i shoqerise “**Proway Group**” Sh.p.k perfaqesohet nga 1 (nje) kuote me vlere totale 100,000 (njeqind mij) leke e cila nuk eshte paguar.

Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise:

- Z. Ergis Mëhillka: Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere të përgjithshme 100,000 (njeqind mije) leke qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

#### NENI 8 Asambleja e Pergjithshme

Vendimet merren nga Asambleja e Pergjithshme. Asambleja e Pergjithshme merr vendime per ceshtjet qe ligji apo Statuti ia rezervon ketij organi, si dhe per ceshtjet per te cilat, Administratori kerkon mendimin apo miratimin e Asamblesë së Pergjithshme.

8.1 Vendimet e Asamblesë së Pergjithshme merren me shkrim dhe regjistrohen ne nje regjister te posacem te mbajtur prane selise se Shoqerise “**Proway Group**” Sh.p.k.

8.2 Jane ne kompetencen ekskluzive te Asamblese së Ortakëve marrja e vendimeve per sa i perket:

- ndryshimit të Statutit;



- riorganizimi i shoqërisë, ndarja, bashkimi, likuidimi, shndërrimi i shoqërisë;
- zmadhimi, zvogëlimi i kapitalit, transferimi i pjeseve të kapitalit themeltar tek të tretët, si dhe blerjen e pjeseve të kapitalit themeltar nga vete shoqëria me qëllim anulimin e tyre;
- emerimi dhe shkarkimi i Administratorit;
- emerimi dhe shkarkimi i eksperteve kontabel të autorizuar;
- miratimi e bilancit;
- si dhe të gjitha kompetencat e tjera që ligji dhe/ose Statuti japin shprehimisht Asamblese

## NENI 9 Organet drejtuese

9.1. Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme në të cilën marrin pjesë Ortakët e Shoqërisë ose përfaqësuesit e tyre të pajisur me prokurë të veçantë; dhe
- Administratorët

## NENI 10 Administratori i Shoqërisë

10.1 Shoqëria administrohet nga Administratori, person fizik që mund të jetë ose jo ortak i Shoqërisë.


10.2 Administratori është të detyruar të drejtojë Shoqërinë në përputhje me ligjin "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Statutin, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme dhe sipas dispozitave të tjera ligjore në fuqi.

10.3 Administratori i Shoqërisë emerohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Ortakëve, si dhe do të qendrojë në detyrë për një kohë prej 5 (pese) vjetësh.

10.4 Administratori e parë të shoqërisë emerohet:

- Z. Ergis Mëhillka, shtetas shqiptar, lindur më 22.12.1992 në Bubullimë, Lushnjë, Shqipëri, identifikuar me nr identifikimi J21222023G, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.

Nënshkrimi i administratorit



10.5 Administratori ka të gjitha kompetencat që i njeh ligji dhe Statuti i Shoqërisë.

## NENI 11 Ligji i zbatueshem dhe mosmarreveshjet

11.1 Për sa nuk parashikohet nga ky Akt Themelimi, reference i bëhet legjislacionit shqiptar në fuqi.

11.2. Për të gjitha mosmarreveshjet brenda shoqërisë që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që nuk mund të zgjidhen me mirekuptim, organi kompetent do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

11.3. Ky dokument redaktohet në 3 (tre) kopje origjinale.

Lexuar, kuptuar, aprovuar e nënshkruar nga ortaku themelues

### ORTAKET THEMELUES

Z. Ergis Mëhillka

Data: 29/09/2021